



**STUDIMET DOKTORALE NË FAKULTETIN EKONOMIK
DHE ATË JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

Punim për diskutim

Nëntor 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është pjesë e projektit “Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës” dhe është realizuar me përkrahjen e projektit *Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)* i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe e Qendrës për Kurajo Politike (CPC) , dhe kursesi nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA apo i KCSF-së.

Përgatitur nga: Mentor Agani

Asistente hulumtuese: Lirije Palushi

Editorë: Lulzim Peci dhe Arben Hajrullahu

Copyright © 2017, KIPRED&CPC. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org dhe: info@cpc-ks.org.

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Akreditimi.....	7
3. Aspektet legale të administrimit të studimeve doktorale	15
4. Aspekte të administrimit, cilësisë dhe resurseve hulumtuese në studimet e doktoratës.....	20
5. Konkluzione për diskutim.....	29

1. HYRJE

Projekti *Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës*, që është duke u punuar bashkarisht nga Instituti Kosovar për Zhvillim dhe Hulimtim të Politikave – KIPRED dhe Qendra për Kurajo Politike – CPC, dhe që përkrahet nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka për qëllim hulimtimin e studimeve doktorale në katër fakultete të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në të cilët studiohen shkencat sociale dhe humanistike: në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Juridik, Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin Filozofik.

Ky projekt do të zhvillohet në tre faza. Në fazën e parë analizohen studimet doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe në atë Juridik. Në fund të kësaj faze jipen produktet e kësaj pjese të projektit: 1) punimi diskutues në të cilin jepet përshkrimi i gjetjeve të kësaj pjese të hulimtit dhe një analizë preliminare e tyre; 2) tryeza diskutuese në të cilën këto gjetje dhe analiza preliminare e tyre do të prezantohen para mysafirëve profesorë dhe studentë doktoralë të këtyre dy fakulteteve dhe do të diskutohen me ta, dhe 3) prezantimi dhe përhapja në opinionin publik e gjetjeve dhe analizës preliminare të tyre, si dhe e përfundimeve të tryezës diskutuese. Në fazën e dytë analizohen studimet doktorale në Fakultetin e Edukimit dhe në atë Filozofik. Edhe kjo fazë në fundin e vet i jep produktet e njëjta si edhe e para, vetëmse për fakultetet përkatëse. Dhe, në fazën e tretë do të bëhet përmbledhja e gjetjeve, analizave preliminare, dhe e përfundimeve të dy tryezave diskutuese paraprake, dhe kjo do të finalizohet me punimin e politikave në të cilin do të jipen rezultatet e hulimtit nga këndvështrimi i përfundimeve të dy tryezave diskutuese, si dhe rekomandimet përkatëse për avancimin e studimeve doktorale në Universitetin e Prishtinës dhe për ngritjen e cilësisë së tyre.

Në dy fazat e para veprimet dhe metodat që do të zbatohen për arritjen e qëllimeve të hulimtit janë disa. Së pari, do të bëhet analiza e dokumentacionit legal dhe administrativ që ka të bëjë me studimet e doktoratave në fakultetet përkatëse. Këtu do të analizohen ligjet që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, me veprimtarinë shkencore hulimtuuese, Statuti dhe

rregulloret përkatëse të Universitetit, raportet e grupeve të ekspertëve që e kanë bërë akreditimin e fakulteteve përkatëse, dokumente të tjera relevante legale/administrative, si dhe hulumtimet e tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë. Po ashtu, do të zhvillohen edhe disa dhjetra intervista të thella, me profesorë mësimdhënës në studimet doktorale, me studentë doktoralë, me zyrtarë të Universitetit të Prishtinës, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe me zyrtarë të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. Analizimi i dokumentacionit legal/administrativ dhe intervistat do të jenë të ndërthurura me njëra-tjetrën – analizimi i dokumentacionit legal/administrativ do të bëhet në frymën e të dhënave që do të fitohen nga intervistat, dhe intervistat do të zhvillohen në frymën e të dhënave të fituara nga analiza e dokumentacionit legal/administrativ.

Në fund, në fazën e tretë, do të bëhet përmbledhja e të gjitha aktiviteteve të ndërmara në dy fazat e para, dhe kjo përmbledhje, siç u tha, do ta ketë trajtën e një punimi të politikave ku do të paraqiten përfundimet e të tërë projektit, dhe rekomandimet përkatëse.

Ky punim diskutues është njëri ndër produktet finale të fazës së parë. Në të janë paraqitur gjetjet dhe një analizë preliminare e të dhënave që janë fituar gjatë hulumtimit të bërë të gjendjes së studimeve doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik.

Përndryshe, punimi përbëhet nga tre pjesë. Në të parën është diskutuar procesi i akreditimit të programeve doktorale të Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit Juridik. Në fillim janë analizuar hollësitë rreth akreditimit për çdonjërin fakultet dhe për çdonjërin program veçmas. Ku ka qenë e nevojshme, janë përmendur edhe zhvillimet që kanë çuar deri te këto akreditime. Këtu janë theksuar anët e forta dhe të dobëta të çdonjërit program veçmas, ashtu siç ato janë dhënë nga grupet e ekspertëve ndërkombëtarë që e kanë bërë vlerësimin e programeve për akreditim. Më pas, është bërë një analizë preliminare lidhur me disa aspekte që kanë të bëjnë me akreditimin në përgjithësi, ku janë dhënë disa gjetje preliminare për vetë procesin akreditues. Pos në hulumtimin e zhvilluar, kjo pjesë është mbështetur në masë të madhe në intervistat e zhvilluara. Këtu janë dhënë vërejtjet për mangësitë e identifikuara në procesin akreditues, si dhe propozimet për përmirësimet e këtij procesi. Po ashtu, në fund të kësaj pjese është dhënë edhe një analizë e idesë për akreditimin e profesorëve për pjesëmarrje në studimet doktorale,

si një që do të mund t'i eliminonte disa mangësi mjaft të mëdha të studimeve doktorale që paraqesin pengesë serioze që këto studime të jenë më cilësore.

Pjesa e dytë ofron një përshkrim të shkurtër dhe një analizë preliminare të dokumenteve legale-normative të cilat e rregullojnë zhvillimin e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Përqendrimi kryesor në këtë pjesë është në Statutin e Universitetit të Prishtinës, dhe në Rregulloren për Studime të Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, ndërkaq, aspektet e shqyrtuara përfshijnë kriteret e regjistrimit në studimet e doktoratës, kohëzgjatjen dhe fazat e këtyre studimeve, dhe procedurat e paraqitjes, të vlerësimit dhe pranimit të projektit të doktoratës dhe të vlerësimit të mbrojtjes së saj.

Në pjesën e tretë janë trajtuar aspektet e administrimit, të cilësisë, si dhe resurset hulumtuese për studimet e doktoratës në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik. Kjo pjesë mbështetet si në analizën e bërë të gjendjes së studimeve të doktoratës në këto dy fakultete, ashtu edhe në intervistat e zhvilluara me profesorët dhe studentët doktoralë të tyre. Këtu janë identifikuar një varg çështjesh që kanë të bëjnë me administrimin, cilësinë dhe hulumtimin në studimet doktorale në këto fakultete, dhe është bërë një analizë preliminare e tyre. Çështjet që kanë të bëjnë me këto tre fusha të studimeve doktorale në UP, domethënë, administrimin, cilësinë, dhe hulumtimin, janë marrë si të ndërthurura me njëra tjetrën, ashtu që ta mundësojnë një vlerësim sa më gjithëpërfshirës dhe sa më të suksesshëm të tyre nga ana e pjesëmarrësve në tryezën diskutuese.

Në fund po i përmendim pjesëmarrësit në intervistat e zhvilluara, duke ju shprehur falënderime për kontributin e dhënë për këtë hulumtim: Profesorit të Asocuar, Dr. Driton Qehaja, Profesorit të Asocuar, Dr. Besnik Krasniqi, Profesorit të Asocuar, Dr. Gazmend Qorraj dhe Profesorit Asistent dhe Dekanit, Dr. But Dedaj, nga Fakulteti Ekonomik, si dhe Profesorit të Rregullt, Dr. Enver Hasani, Profesoreshës së Asocuar, Dr. Gjuljeta Mushkolaj, Profesorit Asistent, Dr. Qerim Qerimi, dhe Profesoreshës Asistente, Dr. Remzije Istrefi nga Fakulteti Juridik, si dhe studentëve doktoralë Mr. Gentrit Berishë, Mr. Simeana Beshi, dhe Mr. Ruzhdi Berisha.

1. AKREDITIMI

Këtu do të ofrohen të dhënat dhe gjetjet kyçe për akreditimin e programeve të doktoratës në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik, si dhe do të shqyrtohen disa aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me procesin e akreditimit që u diskutuan gjatë intervistave të zhvilluara me mësimmshënësit dhe studentët doktoralë të këtyre dy fakulteteve.

1.1 Fakulteti Ekonomik

Me Vendim të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (26 gusht 2015), janë akredituar katër programe të doktoratës të Fakultetit Ekonomik për afatin tre-vjeçar prej 1 tetorit 2016, deri më 30 shtator 2019. Tre nga këto katër programe janë: Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Informatikë; dhe Marketing. Po ashtu, me të njëjtin vendim është akredituar për afatin trevjeçar, prej 1 tetorit 2015 deri më 30 shtator 2018, edhe programi i katërt doktoral në Ekonomi (Ekonomiks), që mbahet në gjuhën angleze. Përndryshe, ky program është planifikuar dhe zhvillohet në kuadrin e Programit TEMPUS të Komisionit Evropian.¹

Këto akreditime kanë ardhur pas dhënies së dy Raporteve Finale të grupit të ekspertëve ndërkombëtarë, në muajt korrik dhe gusht të vitit 2015.² Këto dy raporte i japin vlerësimet e përgjithshme, rekomandimet, si dhe propozimet për akreditim të tyre. Programi doktoral në Ekonomi e ka patur një vlerësim të lartë nga Grupi i Ekspertëve. Kështu, për këtë program Raporti Final vlerëson që:

Cilësia, shtrirja dhe synimet akademike janë në pajtim me gradën akademike; Grada akademike i përgjigjet standardeve ndërkombëtare; Struktura e programit ofron mundësi të mjaftueshme për studim, reflektim dhe analizë të pavarur; Ndarja e kredive

¹ Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Vendim nga Mbledhja 36 e Agjencionit mbajtur më 26.08.2015.

² Public University Prishtina "Hasan Prishtina", Faculty of Economics, Programme Accreditation Report, July 2015, *Final Report, Site visit 2015, July 5th-6th*; dhe *Final Report, Site visit 2015, August 2nd-3rd*.

ECTS është me vend dhe e arsyeshme; Ngarkesa e punës që kërkohet për programin akademik është e menaxhueshme për studentët; Metodatat e mësimdhënies dhe përmbajtja e njësive të mësimit është e mjaftueshme për përmbushjen e suksesshme të qëllimeve të programit; Ndërthurja e përmbajtjes akademike midis pjesëve të ndryshme të kurrikulës është e kuptueshme dhe transparente; Kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve i ndjekin rregullat kombëtare dhe janë të krahasueshme me standardet ndërkombëtare; Raporti i numrit të personelit akademik me atë të studentëve është me vend për ofrimin e një programi me cilësi të lartë; Programet e institucionit e bëjnë kontrollimin e cilësisë në mënyrë të rregullt sipas procedurave kombëtare, por që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare.³

Vërejtjet e dhëna kanë të bëjnë me numrin e pamjaftueshëm të hulumtimeve dhe të publikimeve të personelit, dhe Fakultetit Ekonomik i rekomandohet për ta përkrahur personelin për tejkalimin e këtyre problemeve.⁴

Një vlerësim mjaft pozitiv jipet edhe për programin doktoral Banka, Financa dhe Kontabilitet, por këtu vërejtjeve dhe rekomandimeve për Fakultetin i shtohen edhe përmirësimi i konceptit didaktik, mbikëqyrja nga afër e ngarkesës së punës së studentëve, shfrytëzimi më i madh i kontakteve ndërkombëtare, dhe përmirësimi i infrastrukturës.⁵

Për programin doktoral Menaxhment dhe Informatikë jipen më tepër vërejtje, dhe këto kanë të bëjnë me: nevojën për ta theksuar hulumtimin në përgjithësi, jo vetëm në Ekonomi; përmirësimin e Vizionit dhe përkthimin e tij në anglisht; Përmirësimin e pjesës së Menaxhmentit të Përgjithshëm; faktin që syllabuset janë tejet të ngjashme me njëra-tjetrën; përshkrimin më të detajuar të metodave të mësimdhënies; numrin e madh të studentëve në seminare (ky numër është 35, dhe kërkohet të jetë nën 20); dhënien e kredive ECTS edhe për internshipe/praktikume, dhe; fakulteti këshillohet që shpërndarjen e përgjegjësive midis stafit ta bëjë transparente.⁶ Po ashtu, sa i përket hulumtimit, theksohet që kjo pjesë është vërtetë e dobët, dhe vihet në dukje ajo që, ndërkohë që profesorët ankohen që nuk kanë kohë, ata e

³ *Final Report, Site visit 2015, August 2nd-3rd*, fq. 25-8.

⁴ *Ibid.*, fq. 28-9.

⁵ *Final Report, Site visit 2015, July 5th-6th*, fq. 66-9.

⁶ *Ibid.*, fq. 70-2.

shfrytëzojnë çdo mundësi të shkojnë për të punuar nëpër universitetet e tjera. Rekomandohet, po ashtu, që studentët të kenë mbikëqyrës të jashtëm, që numri i botimeve që duhen përgatitur për publikimet e jashtme të rritet nga një në tre, dhe që Universiteti ta përpilojë strategjinë dhe buxhetin për institutin hulumtues.⁷

Programit doktoral në Marketing i rekomandohet të vazhdohet me dhënien e disa kurseve në gjuhën angleze, forcimi i kësaj praktike, ftimi i më shumë profesorëve të jashtëm për të ligjëruar, rritja e personelit që punon me orar të plotë, përmirësimi i përmasës dhe cilësisë së bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe rritja e përfshirjes së studentëve doktoralë në hulumtime jashtë temave të tyre të doktoratës.

1.2 Fakulteti Juridik

Akreditimi i programeve të tashme doktorale të Fakultetit Juridik ka shkuar në një proces pak më të gjatë se ai i atyre të Fakultetit Ekonomik. Me Vendim të Këshillit Shtetëror të Cilësisë janë zgjatur për një periudhë njëvjeçare, prej 1 tetorit 2016, deri më 31 shtator 2017, periudhat e akreditimit të pesë programeve doktorale të Fakultetit Juridik: E Drejta Penale; E Drejta Civile; E Drejta Kushtetuese Administrative; E Drejta Financiare, dhe; E Drejta Ndërkombëtare.⁸ Më pas, me datën 12 maj 2016, Fakulteti Juridik ka parashtruar kërkesë që periudha e këtij akreditimi të zgjatet nga një në tre vjet, e cila kërkesë u refuzua nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë.⁹ Arsyetimi i këtij refuzimi bëhet duke u bazuar në Raportin Final të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit për Fakultetin Juridik, ku përmenden disa çështje thelbësore si: 1) Cilësia e dobët e Raportit të Vetëvlerësimit dhe mungesa e informatave; 2) Përmbajtja identike e përshkrimit të programeve të ndryshme në vlerësim; 3) Dyfishimi i plan-programeve (kurrikulave) në programet studimore në nivele të ndryshme të studimit; 4) Disproporcioni i lartë midis numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimit në raport me numrin e stafit akademik,

⁷ *Ibid.*, fq. 72-4.

⁸ Vendim i Këshillit Shtetëror të Cilësisë i marrë në mbledhjen e tij të 41-të të 14 prillit 2016.

⁹ Vendim i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, i marrë në mbledhjen e tij të 42-të të 31 majit 2016.

dhe; 5) Mospërmbushja e kërkesave bazike për numrin e studentëve të regjistruar për sa i përket hapësirave në Fakultetin Juridik.¹⁰

Vetëm në mbledhjen e 51-të, të 23 qershorit 2017, Këshilli Shtetëror i Cilësisë mori vendim për akreditimin për periudhën pesëvjeçare, 1 tetor 2017 - 30 shtator 2022, të dy programeve doktorale në Fakultetin Juridik: E Drejta Ndërkombëtare, dhe; E Drejta Kushtetuese dhe Administrative, me leje për të regjistruar maksimalisht dhjetë studentë për një vit akademik për program. Ndërkaq, rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të dhëna në Raportin Final janë: 1) rritja e hulumtimit shkencor, sipas mundësisë me pjesëmarrje të studentëve doktoralë; 2) zhvillimi i lidhjeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare për t'i shtuar hulumtimet ndërkombëtare; 3) implementimi i strukturës për sigurimin e cilësisë për nevojat e veçanta të programeve doktorale, dhe; 4) pasja e një programi të internshipit për studentët

1.3 Aspekte akredituese të studimeve doktorale në UP

Në këtë seksion do të ofrohet një vlerësim i përgjithshëm i procesit akreditues të programeve doktorale, si dhe ideja e akreditimit të profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale, të cilat janë rezultat i hulumtimit dhe intervistave me profesorët dhe studentët doktoralë të Fakultetit Ekonomik dhe të atij Juridik.

1.3.1 Vlerësimi i përgjithshëm i procesit akreditues të programeve doktorale

Vërejtjet dhe çështjet kryesore të identifikuar gjatë intervistimit të profesorëve dhe kandidatëve doktoralë lidhur me vlerësimin e programeve doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik janë si në vijim: Kushtet dhe kriteret e AKA-së për akreditimin e programeve doktorale janë formale, administrative dhe minimaliste, dhe ato nuk përqendrohen sa duhet në aspektet përmbajtësore, dhe kjo, rrjedhimisht, rezulton në rekomandime të po të njëjtave natyra nga Grupet e Ekspertëve; Nevoja që akreditimi i programeve doktorale të bëhet ndaras nga akreditimi i programeve të niveleve Bachelor dhe Master; Mungesa e mekanizmave

¹⁰ *Ibid.* Përndryshe, këto çështje, si dhe shumë të tjera, shihen në Raportin Final të grupit të ekspertëve ndërkombëtarë. Shih, External Experts Team, *Final Evaluation Report: Faculty of Law, University of Prishtina*, 2015.

institucionalë për kontrollimin e jetësimit të programeve ekzistuese doktorale sipas kushteve me të cilat ato janë akredituar, dhe; nevoja që AKA të përqendrohet më tepër në resurset e pamjaftueshme që UP i ndan për mobilitetin e studentëve të doktoralë.

Për sa i përket kushteve dhe kriterëve të AKA-së, Prof. Dr. Enver Hasani i Fakultetit Juridik thekson që kushtet që i parashtron Agjencia e Akreditimit janë vetëm administrative, dhe sipas tij përqendrimi është vetëm në formë, p.sh. tre profesorë që janë doktorë shkencash, pa u përqendruar në çështjet substanciale për cilësinë e këtyre programeve, si p.sh. kredencialet akademike të profesorëve dhe përmbajtja e programeve doktorale.¹¹

Vlerësime të ngajshme ka dhënë edhe Prof. Dr. Qerim Qerimi i Fakultetit Juridik, i cili thekson se AKA ka shërbyer deri më tani më tepër si një mekanizëm për verifikim formal të plotësimit të kushteve për studimet doktorale, pa u përqendruar në dimensionet përmbajtësore si cilësia e personelit akademik dhe e planprogramit. Qerimi e parashtron çështjen e domosdoshmërisë së ndryshimit të procesit të vlerësimit nga ana e ekspertëve të jashtëm për studimet doktorale, përmes krijimit të një komisioni të veçantë të ekspertëve të jashtëm që kanë përvojë të dëshmuar në ofrimin e studimeve doktorale, dhe që do të merreshin me akreditim vetëm për këtë nivel të studimeve.¹²

Prof. Dr. But Dedaj, i Fakultetit Ekonomik, vuri në pah kontrollin e kufizuar të zbatimit të rekomandimeve të AKA-së për programet e ofruara për zhvillimin e studimeve të doktoratës. Sipas tij, së bashku me rekomandimet duhet të përcaktohet edhe plani i detajuar i veprimeve që duhen zbatuar brenda afateve përkatëse kohore, përfshirë këtu edhe caktimin e mekanizmave për kontrollimin e zbatimit të tyre,¹³ ku, në rast të moszbatimit të studimeve të doktoratës ashtu siç ato janë akredituar, akreditimi duhet tërhequr.¹⁴

Çështja e mungesës së kriterit të mobilitetit të studentëve doktorale me rastin e akreditimit të programeve doktorale është identifikuar nga studenti doktorale, Mr. Ruzhdi Morina. Ai theksoi që për përgatitje cilësore të temave të doktoratës studentëve duhet t'u mundësohen qëndrime

¹¹ Intervistë, Enver Hasani, 26 korrik 2017.

¹² Intervistë, Qerim Qerimi, 17 gusht 2017.

¹³ Intervistë, But Dedaj, 28 gusht 2017.

¹⁴ *Ibid.*

disa-javore apo -mujore në institute apo fakultete jashtë vendit, për t'i rritur dijet dhe shkathtësitë e hulumtimit të pavarur.¹⁵ Megjithatë, duhet theksuar që mundësi të mobilitetit të studentëve doktorale ofrohen nga programi i bursave Marie Skłodowska-Curie Actions, i programit Horizon 2020 të Erasmus Plus-it për Kosovën.¹⁶ Sidoqoftë, mbetet çështje që duhet trajtuar ajo sa këto mundësi janë shfrytëzuar deri më tash, dhe çfarë asistence ofrojnë fakultetet dhe UP-ja për shfrytëzimin e mundësive të tilla.

1.3.2 Akreditimi i profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale

Një nga çështjet më të diskutuara në intervistat e realizuara, ka qenë natyra tejet formale për vlerësimin e kompetencave të profesorëve për mësimdhënie në studimet doktorale nga ana e AKA-së. Vërejtjet që janë bërë më së shpeshti kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të profesorëve dhe mentorëve në studimet doktorale sa i përket njohjes së gjuhës angleze, apo të gjuhëve të tjera botorërore, si dhe të kompetencave të tyre për hulumtim shkencor.

Lidhur me këtë, Hasani vë në pah faktin që disa nga kërkesat që u parashtrihen studentëve doktorale nuk i plotësojnë as shumë nga profesorët e tyre, duke shtuar që vetëm dikund rreth 30 përqind e profesorëve të Fakultetit Juridik qëndrojnë mirë në njohjen e gjuhës angleze, ndërkaq, të tjerët nuk janë në gjendje ta përcjellin literaturën në anglisht, apo, të paktën, jo pa vështirësi serioze. Në këtë mënyrë, sipas Hasanit, krijohet një situatë paradoksale, ku prej studentëve të doktoratës kërkohet të botojnë nëpër revista shkencore ndërkombëtare, të cilat disa prej profesorëve të tyre nuk janë në gjendje as t'i lexojnë.¹⁷

Një situatë të ngjashme e paraqet edhe Profesori i Fakultetit Ekonomik, Dr. Driton Qehaja, i cili konstaton që numri i profesorëve që janë në gjendje ta përcjellin literaturën në gjuhën angleze nuk e arrin njëzetëshin: për më tepër, ai shton që edhe ky vlerësim mund të jetë tejet optimist.¹⁸ Për sa i përket kompetencave hulumtuese Hasani theksoi që disa nga profesorët që

¹⁵ Intervistë, Ruzhdi Morina, 14 shtator 2017.

¹⁶ <http://www.erasmuspluskosovo.org/scholarships>

¹⁷ Intervistë, Enver Hasani, 26 korrik 2017.

¹⁸ Intervistë, Driton Qehaja, 3 gusht 2017.

janë bërë ordinarë, në jetë të vet, as që kanë botuar dhe as nuk do të botojnë ndonjë punim shkencor, ndërkohë që këtë e kërkojnë nga të studentët.¹⁹

Ngjajshëm edhe Profesori në Fakultetin Ekonomik, Dr. Besnik Krasniqi, vë në pah faktin që disa profesorëve që e kanë kryer shkollimin në sisteme të kaluara, ju mungon trajnimi adekuat për metodologji hulumtuese [...] dhe që kjo e paraqet një problem shumë të madh, sidomos kur kemi të bëjmë me mentorimin e studentëve.²⁰

Analiza e këtij problemi e vë në pah që një nga burimet e tij qëndron në aspektet legale të arsimit të lartë në Kosovë. Kështu, kriteret për mentorim të Rregullores për Studime të Doktoratës të UP-së përcaktojnë që mentori duhet ta ketë titullin e Profesorit të Rregullt ose të Asocuar.²¹ Nga ana tjetër, sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, titujt e Profesorit të Rregullt dhe të Asocuar mund t'i kenë vetëm mësimdhënësit që kanë botime jashtë vendit me recension ndërkombëtar.²² Me fjalë të tjera, plotësimi i kushteve për titujt e Profesorit të Rregullt dhe të Asocuar e *nënkupton ligjërisht* që mësimdhënësi ka kompetencë në gjuhën angleze (ose në ndonjë gjuhë tjetër kryesore botërore), si dhe kompetencë në hulumtimin shkencor. Më pas, këtë *nënkuptim* të kompetencave, AKA e merr si të mirëqenë dhe valid. Mirëpo, siç shihet nga hulumtimi jonë, kjo nuk vlen gjithmonë, duke patur parasysh faktin që një numër profesorësh i kanë marrë titujt në fjalë para shtatorit 2011, kur Ligji për Arsimin e Lartë ka hyrë në fuqi, dhe kriteret e sipërpërmendura nuk kanë mundur të zbatohen në mënyrë retroaktive për profesorët në fjalë, dhe kjo e dëmton seriozisht cilësinë e studimeve të doktoratës.

Duke qenë të vetëdijshëm për këtë gjendje, në hulumtimin tonë e kemi parashtruar edhe idenë për akreditimin e profesorëve për studime të doktoratës. Lidhur me këtë Krasniqi theksoi që kjo do ta rregullonte cilësinë e mentorimit meqë kushti që profesori të jetë i rregullt e nënkupton që ai ka aktivitet hulumtues, por ka mjaftë profesorë të rregullt që këtë nuk e përmbushin, dhe kjo ndikon në cilësinë e studimeve doktorale.²³ Ndërkaq Hasani mendon që nëse bëhet ndarja e

¹⁹ Intervistë, Enver Hasani, 26 korrik 2017.

²⁰ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017.

²¹ Rregullore për Studimet e Doktoratës e UP-së, Neni 9, (1) 1. Sipas Pikës (1) 2 të këtij Neni, të drejtë për të udhëhequr kandidat për doktoratë ka edhe Profesori Asistent që ka punime të botuara në revista me recension ndërkombëtar.

²² Neni 26, Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-037, 29 gusht 2011..

²³ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017.

kriterit të akreditimit nga titujt e profesorëve universitarë, atëherë kjo do të ishte një fitore e madhe, meqë profesorët do të vlerësoheshin përmes hulumtimeve, përkatësisht punimeve shkencore, dhe jo përmes titujve universitarë, të cilët mjaft shpesh nuk korrespondojnë me kompetencat e bartësve të tyre. Kështu, profesorët që kanë mbi pesë punime shkencore të krahasueshme dhe konkurruese me cilësinë ndërkombëtare, mund të përfshihen në studimet e doktoratës pavarësisht thirrjes akademike.²⁴ Akreditimi i profesorëve do ta rriste cilësinë e studimeve doktrale përmes sforcimit të kriterit të hulumtimeve shkencore, gjë kjo që njëkohësisht do ta eliminonte edhe problemin e mosnjohjes së gjuhës angleze dhe të pamundësisë së përcjelljes së literatures shkencore në këtë apo në gjuhët tjera botërore nga një numër i konsiderueshëm profesorësh në UP.

²⁴ Intervistë, Enver Hasani, 26 korrik 2017.

2. ASPEKTET LEGALE TË ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE DOKTORALE NË UP

Studimet doktorale në UP rregullohen dhe administrohen në bazë të ligjeve dhe dokumenteve legale vijuese: Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Rregullorja për Studimet e Doktoratës e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.²⁵

Organet kryesore për marrjen e vendimeve relevante për zhvillimin e studimeve të doktoratës në UP janë Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, si Këshill i përhershëm i Senatit të UP-së, Këshilli i Studimeve të Doktoratës i Njësisë Akadematike – Fakultetit, si Këshill i përhershëm i Këshillit të Fakultetit, pastaj Këshilli i Fakultetit, si dhe Senati i UP-së, si një organ për miratimin përfundimtar të vendimeve të propozuara nga organet e sipërpërmendura.

Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës përbëhet nga 14 anëtarë: Rektori, Prorektori për kërkime shkencore, Prorektori për mësim, një përfaqësues i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dhe dhjetë profesorë të rregullt ose të asocuar nga këta lëmenj: lëmi i shkencave shoqërore, lëmi i shkencave humanistike, lëmi i shkencave teknike, lëmi i arteve, lëmi i shkencave matematike-natyrore, lëmi i mjekësisë, lëmi i shkencave të bujqësisë dhe veterinarisë, lëmi i shkencave juridike, lëmi i shkencave ekonomike dhe lëmi i edukimit fizik dhe sportit. Po ashtu, anëtar i këtij Këshilli është edhe Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik, por ky është anëtar pa të drejtë vote.²⁶

Studimet e doktoratës i udhëheq Këshilli i Studimeve të Doktoratës në njësinë përkatëse akademike – fakultet,²⁷ dhe ky përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve nga çdonjëri departament i njësisë akademike.²⁸

²⁵ Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, 04/L-037, 29 gusht 2011, <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20e%20larte.pdf>. ; Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, 04/L-135, 28 mars 2013, <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20veprimtari%20kerkimore%20shkencorel.pdf>. Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”; dhe, Rregullore për Studimet e Doktoratës e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” 2.9.2016. Dy dokumentet e fundit janë në dispozicion në: <http://###.uni-pr.edu/>.

²⁶ Rregullore për Studimet e Doktoratës, Neni 2.2.

²⁷ *Ibid.*, Neni 3 (3).

²⁸ *Ibid.*, Neni 2.1.

Po ashtu, çdo njësi akademike – fakultet, ka Këshillin e Fakultetit, anëtarët e të cilit janë dekani i fakultetit, prodekani/prodekanët, sekretari i fakultetit, deri në tridhjetë anëtarë të zgjedhur nga radhët e profesorëve të fakultetit, deri në 8 anëtarë të zgjedhur nga radhët e asistentëve të fakultetit, një anëtar i zgjedhur nga personeli joakademik i fakultetit, dhe dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit.²⁹

Dhe, në fund, Senati i Universitetit është organi më i lartë akademik i Universitetit,³⁰ që ka këtë përbërje: rektori, prorektorët, dekanët e të gjitha njësive akademike – fakulteteve, nga një anëtar nga stafi akademik i çdonjërës njësi akademike, shtatë anëtarë nga parlamenti i studentëve, dhe dy anëtarë nga stafi joakademik. Sekretari i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit pa të drejtë vote.

2.1.1 Regjistrimi në studimet e doktoraturës

Sipas Rregullores për Studimet e Doktoratës, regjistrimi në këto studime bëhet me konkurs publik që shpallet të paktën një muaj para fillimit të vitit akademik, dhe të drejtë konkurrimi kanë personat që kanë magjistraturë shkencore, titullin master shkencor, të diplomuarit që kanë të paktën 300 ECTS kredite, kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në çdonjërin nivel të studimeve paraprake, dhe kandidatët që kanë dëshminë për njohjen e një gjuhe botërore (anglisht, gjermanisht, frengjisht, ose gjuhë tjetër botërore).³¹

Kriteret për regjistrim përfshijnë suksesin në studimet paraprake, interesimin për kërkime shkencore, punimet e botuara dhe rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës. Kriteret për përcaktimin e përparësisë në radhitjen përzgjedhëse janë nota mesatare, aktiviteti kërkimor-shkencor dhe njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër botërore. Nota mesatare në studimet themelore dhe ato master vlerësohet me vlerë maksimale prej 40 pikësh (nota mesatare 8–8.50, 5 pikë; 8.51–9.00, 10 pikë; 9.01–9.50, 15 pikë, dhe 9.51–10.00, 20 pikë.

²⁹ Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Neni 73.

³⁰ *Ibid.*, Neni 42.

³¹ Rregullore për Studimet e Doktoratës, Neni 7 (2). Ashtu siç është parashtruar këtu, kriteri i dëshmisë së njohjes së një gjuhe të huaj botërore, mundëson të drejtën e konkurrimit për regjistrim në studimet e doktoratës, dhe nuk është kusht për regjistrim në to.

Në kuadër të kësaj, magjistratura shkencore ose specializimi vlerësohen me 5 pikë).³² Aktiviteti kërkimor-shkencor vlerësohet deri në 35 pikë, ku vlerësohen artikujt e botuar në pesë vitet e fundit të indeksuar në *Current Contents*, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revista akademike vendëse (UP, ASHAK, Instituti Albanologjik dhe ai i Historisë), librat universitarë të botuar në pesë vitet e fundit, prezantimet gojore të punimit në pesë vitet e fundit në tubime shkencore ndërkombëtare të indeksuara, dhe prezantimet gojore në tubimet shkencore vendëse.³³ Dhe, së fundi, njohuria e gjuhës angleze ose e një gjuhe të huaj botërore vlerësohet deri në 20 pikë.³⁴

Po ashtu, numrin e studentëve për regjistrim e propozon njësia akademike – fakulteti, e shqyrton Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, dhe e miraton Senati.³⁵

2.1.2 Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës

Kohëzgjatja e studimeve të doktoratës në UP është gjashtë semestra, dhe gjatë tyre studentët i fitojnë: 30 ECTS në semestrin e parë, për dhënien e provimeve nga lëndët e këtij semestri; 30 ECTS në semestrin e dytë, për punimet seminarike në lëndët e këtij semestri; 30 ECTS për vlerësimin pozitiv dhe miratimin e projekt-propozimit të doktoratës; 90 ECTS në tre semestrat e fundit, dhe atë, për të paktën një publikim shkencor të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (20 ECTS), të paktën dy prezantimeve në tubimet shkencore, ku njëra duhet të jetë ndërkombëtare (10 ECTS), dhe mbrojtjes publike të doktoratës (60 ECTS).³⁶

³² *Ibid.*, Neni 7 (4) 1. dhe 2.

³³ *Ibid.*, Neni 7 (4) 3.

³⁴ *Ibid.*, Neni 7 (4) 4.

³⁵ *Ibid.*, Neni 7 (2). **Vërejtje:** Me gjasë për shkak të ndonjë gabimi teknik, pika (2) e Nenit 7 në këtë Rregullore përsëritet dy herë, dhe atë me përmbajtje të ndryshme. Këtu është fjala për pikën e dytë (2) të Nenit 7.

³⁶ *Ibid.*, Neni 8.

2.1.3 Procedurat e paraqitjes, vlerësimit dhe pranimit të projektit të doktoratës, dhe të vlerësimit e mbrojtjes së punimit të doktoratës

Propozimin e mentorit dhe të temës doktoranti e bën gjatë vitit të parë, me ç'rast paraqet titullin e temës dhe mentorin e propozuar duke arsyetuar temën e propozuar dhe pritjet e kontributit shkencor të hulumtimit, si dhe vlerësimin e shpenzimeve të hulumtimit. Pas kësaj, Këshilli i fakultetit, me propozim të Këshillit për Studimet e Doktoratës, në afat prej një muaji e emëron komisionin tre- ose pesë-anëtarësh për vlerësimin e temës, dhe eventualisht miraton propozimin për mentorin. Ky Komision, në afat prej një muaji e jep vlerësimin për kontributin shkencor të temës së propozuar. Propozimin e këtij Komisioni, Këshilli i studimeve të doktoratës të fakultetit duhet ta shqyrtojë në semestrin e tretë, dhe 30 ditë pas dorëzimit të raportit të Komisionit projekt-propozimi mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të fakultetit. Në fund, Këshilli i Fakultetit, me propozim të Këshillit të Studimeve të Doktoratës, temën dhe mentorin ia propozon Senatit të Universitetit për miratim.³⁷

Ndërkaq, punimin e doktoratës, në formë të shkruar në letër dhe në atë elektronike, kandidati e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në Universitet. Me propozim të Këshillit të Studimeve të Doktoratës, Këshilli i Fakultetit e emëron Komisionin tre- ose pesë-anëtarësh për vlerësimin e punimit të doktoratës. Njëherësh me emërimin e këtij Komisioni, Universiteti e shpall në ueb-faqen e vet titullin dhe rezymenë e punimit në shqip dhe anglisht. Komisioni vlerësues është i obliguar që brenda një muaji ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës, dhe ky vlerësim mund të jetë pranim i punimit të doktoratës, kërkesë për plotësimin e tij, dhe refuzim i tij, që e përmban arsyetimin e vendimit. Në fund, në seancën e ardhshme, Këshilli i Fakultetit, me propozimin e Komisionit, i propozon Senatit emërimin e Komisionit për mbrojtjen publike të punimit të doktoratës.³⁸

Mbrojtja e punimit të doktoratës mund të bëhet pasi Këshilli i Fakultetit ta ketë miratuar vlerësimin pozitiv të Komisionit vlerësues, i cili duhet të ratifikohet nga Senati brenda afatit prej dy muajsh nga data e dorëzimit në Komisionin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Nga dita e ratifikimit në Senat, doktoranti në marrëveshje me dekanin dhe me Komisionin për mbrojtje të

³⁷ *Ibid.*, Neni 15.

³⁸ *Ibid.*, Neni 16.

doktoratës, duhet në afat prej një muaji nga data e ratifikimit në Senat ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës.³⁹ Pas mbrojtjes së punimit të doktoratës, ky botohet në faqen e Internetit të Universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes.⁴⁰ Doktoranti e fiton të drejtën e doktorit që nga dita e mbrojtjes së suksesshme të punimit të doktoratës, ndërkaq, të drejtat e plota të gradës akademike me rastin e promovimit.⁴¹

³⁹ *Ibid.*, Neni 17.

⁴⁰ *Ibid.*, Neni 19.

⁴¹ *Ibid.*, Neni 20.

3. ASPEKTE TË ADMINISTRIMIT, CILËSISË DHE RESURSEVE HULUMUTESE NË STUDIMET E DOKTORATËS

Në këtë kapitull do të trajohen problemet e koherencës administrative në studimet doktorale, pastaj, ato të kriterëve të pranimit të studentëve në këto studime dhe ato të zhvillimit të tyre, si dhe çështjet e ndërlidhura me hulumtimin dhe mentorimin, si përcaktues kryesorë të cilësisë së studimeve doktorale, e që janë rezultat i hulumtimit dhe intervistave me profesorët dhe studentët doktoralë të Fakultetit Ekonomik dhe të atij Juridik.

3.1 Mungesa e koherencës administrative afatgjatë në administrimin e studimeve doktorale

Njëri ndër problemet më të rëndësishme të identifikuar që kanë të bëjnë me administrimin e studimeve doktorale është ai i mungesës së koherencës administrative afatgjatë dhe i pasojave me të cilat përballen doktorantët me rastin e ndryshimeve të strukturave udhëheqëse të Universitetit.

Në intervistat e zhvilluara, Qerimi vë në dukje që në periudhën rreth dhjetëvjeçare janë ndërruar katër rregullore për studimet e doktoratës, ku çdonjëra ka modifikuar strukturën e studimeve doktorale.⁴² Ndërkaq, Qorraaj thekson që me rastin e ndryshimeve të strukturave udhëheqëse të UP-së, studentët e doktoratës shpenzojnë më shumë kohë duke u marrë me aspektet administrative se me shkencë ose hulumtim. Me rastin e ndryshimit të rektorit, për shembull, vendosen rregulla të reja, dhe nuk ka platformë të qëndrueshme, kështu që studentët shpesh herë nuk dinë se çfarë kërkohet nga ta dhe se çfarë duhet të bëjnë. Prandaj, sipas Qorraajt, kjo paqëndrueshmëri administrative e Universitetit ka qenë njëri ndër faktorët që kanë shkaktuar problemet më të mëdha në zbatimin e studimeve doktorale të deritashme.⁴³

⁴² Intervistë, Qerim Qerimi, 17 gusht 2017.

⁴³ Intervistë, Gazmend Qorraaj, 6 shtator 2017.

Si ilustrim i kësaj, asistenti dhe doktoranti në Fakultetin Ekonomik Mr. Gentrin Berisha tregon që studimet e doktoratës i ka filluar në vitin 2013, dhe që këto filluan të zhvillohen me rreth gjysmë viti vonesë. Më pas, ai me disa nga kolegët të gjeneratës i kanë dhënë tre provimet e semestrit të parë, dhe i kanë punuar tre punimet semestrale të semestrit të dytë. Pas kësaj, ai, së bashku me kolegët e gjeneratës, i kanë dhënë propozimet për temat e doktoratave të tyre, dhe – për shkak të ndërrimit të rektorit që kishte ndodhur në atë kohë – miratimi i atyre propozimeve është bërë me një vonesë prej rreth një viti e gjysmë. Pra, në një periudhë rreth trevjeçare – e që është periudha e paraparë për përfundimin e studimeve të doktoratës – Berisha dhe kolegët e tij të studimeve doktrale i kanë humbur nga dy vite çdonjëri si pasojë e neglizhencave dhe mungesës së konsistencës administrative administrative.⁴⁴

3.2 Kriteret e pranimit në studimet doktrale dhe kriteret e zhvillimit të këtyre studimeve

Çështja e kriterëve të pranimit dhe të zhvillimit të studimeve doktrale u përmend si problematike në disa nga intervistat e zhvilluara. Kështu, Qerimi thekson që në studimet e mëparshme të doktoratës ka qenë problematike çështja e vlerësimit me pikë të një interviste që me kandidatët për doktorantë e kishin zhvilluar komisionet e pranimit. Kjo kishte rezultuar me ankesa të shumta të kandidatëve që konsideronin që në procesin e përzgjedhjes ishin penalizuar pikërisht për shkak të kësaj interviste. Ai e konsideron tejet të diskutueshme nëse një intervistë dhjetë- a pesëmbëdhjetë-minutëshe mund të jetë më objektive, më e saktë, dhe më kredibile, se një varg faktorësh të tjerë që e demonstrojnë rezultatin dhe aftësitë e kandidatit. Në ndërkohë kjo është ndryshuar, dhe Rregullorja e tashme e parasheh mundësinë e intervistimit të kandidatëve, por intervistat tash nuk mbartin pikë me vete.⁴⁵ Megjithatë, mbajtja e mundësisë së intervistave është e pakuptimtë në kohën kur ato nuk mbartin pikë, pasi mbetet i paqartë funksioni i zhvillimit të tyre.

Mirëpo, sipas Qerimit, në konkursin e fundit është zbatuar një model i ri i pranimit që e përfshinte organizimin e një provimi me shkrim për kandidatët, e i cili ka mbartur me vete një

⁴⁴ Intervistë, Gentrin Berisha, 18 gusht 2017.

⁴⁵ Intervistë, Qerim Qerimi, 17 gusht, 2017.

vlerë totale të pikëve që ka qenë më e madhe se shumica e tërësishme e pikëve që i mbartnin të gjitha kriteret e tjera së bashku, të tilla si njohja e gjuhës së huaj, botimet e ndryshme me recension ndërkombëtar, etj. Kështu që, sipas Qerimit duhet vëmendje dhe debat se a është e përshtatshme dhe e nevojshme të organizohen provime pranuese për kandidatët për studimet doktorale, dhe për atë se çfarë duhet të jetë vlera e këtij provimi në raport me kriteret e tjera për pranimin e një studenti doktoratë.⁴⁶

Njëri ndër kriteret më problematike të zhvillimit të studimeve të doktoratës është çështja e kërkesës për botime të jashtme që u shtrohet studentëve doktoralë. Kështu, këtë çështje e analizojmë në hollësi njëri nga Raportet Finale të bëra nga grupi i ekspertëve që e kanë vlerësuar njëri nga kërkesat për akreditim të Fakultetit Juridik. Është fjala për Raportin Final të vitit 2015, në të cilin, ndër të tjera, Grupi i Ekspertëve shkruan:

“Brenda jonë e dytë ka të bëjë me kërkesën që një pjesë e konsiderueshme e disertacionit të doktoratës të kandidatit duhet të botohet ‘në një revistë shkencore ndërkombëtare nga fusha përkatëse, e cila ka recension ndërkombëtar, dhe që është me impakt-faktor ndërkombëtar.

Duke patur parasysh mjedisin tejet të kufizuar të revistave juridike në gjuhën shqipe, pastaj mjedisin tejet konkurrent të revistave ndërkombëtare, si dhe procesin tejet të gjatë të recensionit të dorëshkrimeve që kryhet nëpër këto revista, e i cili mund t’i merr gjashtë muaj deri në një vit, nëse jo edhe më tepër, atëherë kërkesa për të patur “një pjesë të konsiderueshme të tezës së kandidatit” të botuar në një kësi reviste duket se është një kusht për së tepërmi kërkues, që është me shumë gjasë që do ta bllokojë progresin e studentit në përpjekjet për t’i kryer studimet e tij të doktoratës.

Në të vërtetë, duke patur parasysh që asnjëri nga pesë programet doktorale që i kemi vlerësuar nuk ka qenë në gjendje ta japë as edhe një doktor të vetëm në tri vitet e fundit (2012/2013, 2013/2014 dhe 2014/2015), dhe që, për më tepër, shumica e studentëve as që janë duke bërë progres me një ritëm “të duhur” në këto studime, Grupi i Ekspertëve nuk mund t’i ikë përshtypjes që rregullimi i studimeve të doktoratës është i

⁴⁶ *Ibid.*

papërshtatshëm për qëllimin e tyre, dhe i papërputhshëm me gjendjen aktuale në Fakultetin Juridik të UP-së”⁴⁷

Përndryshe, kjo kërkesë për botime të jashtme nuk është kërkesë që u shtrohet vetëm studentëve të Fakultetit Juridik – kjo është një kërkesë që u shtrohet të gjithë studentëve doktorale në UP, përmes Rregullores për Studime Doktorale.⁴⁸ Po ashtu, kjo kërkesë është përmendur si tejet problematike edhe nga disa profesorë të intervistuar. Kështu, disa nga kërkesat që u parashtrohen studentëve rreth gjuhës angleze dhe hulumtimeve e botimeve, nuk i plotësojnë as disa nga profesorët e tyre.

Krasniqi vë në pah shpërputhjen mjaft të madhe midis numrit të studentëve të doktoratës (në Fakultetin Ekonomik, rreth 100 studentë) dhe kapaciteteve mentoruese. Më tutje ai vlerëson që për sa i përket kriterëve të pranimit, mund të ndodhë të pranohen edhe studentë që nuk kanë ndonjë potencial për t’u marrë me kërkime në të ardhmen, sidomos për shkak të mosnjohjes së gjuhës angleze. Ka patur studentë në të kaluarën, që janë pranuar edhe pa e njohur anglishten, dhe kjo ka bërë që të ngulmohet që kriter i domosdoshëm dhe eliminues për pranim të kandidatëve në të ardhmen të jetë testi TOEFL.⁴⁹ Për më tepër, sipas Krasniqit edhe kriteri i notës mesatare është mjaft i devaluuar, dhe nuk do të duhej të merret si bazë, para së gjithash, për shkak se ka dallime të mëdha midis universiteteve në Kosovë, përkatësisht, midis Universitetit të Prishtinës, dhe, për shembull, të universiteteve publike që janë hapur në qytetet e tjera të Kosovës. Më tutje Krasniqi thekson edhe faktin paradoksal që sistemi i studimeve doktorale në UP, si dhe UP-ja në tërësi, nganjëherë kanë qenë mjaft përjashtuese ndaj kandidatëve që studimet e masterit i kanë përfunduar në vendet perëndimore.⁵⁰ Sido që të jetë, sipas Krasniqit sfidë thelbësore mbeten kapacitet e pamjaftueshme të profesorëve për t’i aftësuar studentët për kërkime dhe hulumtime në të ardhmen, meqë, numri i tyre është

⁴⁷ *Final Evaluation Report*, 2015, fq. 34. Përkthimi në shqip është i KIPRED-it.

⁴⁸ Rregullore për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Neni 8 (Fazat e studimeve të doktoratës), në pikën e vet 4 thotë:

“4. Në tre semestrat e mbetur, studenti i akumulon 90 ECTS përmes: Së paku një publikimi shkencor të një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (shih revistat e caktuara nga njësitë akademike) me recension ndërkombëtar nga lëmi përkatës (20 ECTS); ...”.

⁴⁹ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017

⁵⁰ *Ibid.*

shumë larg nga ajo që do të ishte një optimum për t'i mentoruar p.sh. njëqind e dhjetë-pesëmbëdhjetë studentët aktivë në studimet e doktoratës.⁵¹

3.3 Hulumtimi dhe mentorimi në studimet doktorale

Sipas *Dokumentit të Bardhë*⁵² për financimin e qëndrueshëm të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë, për sa i përket administrimit të veprimtarive mësimdhënëse dhe hulumtuese, për kategorinë e profesorëve të rregullt rekomandohet që raporti ndërmjet mësimdhënies dhe hulumtimit duhet të anojë kah hulumtimi intenziv, dhe atë me 10% mësimdhënie, 70% hulumtim, ndërsa 20% shërbime të tjera. Ndërkaq, për kategorinë e profesorëve të asocuar ky raport rekomandohet të jetë me 20% mësimdhënie, 60% hulumtim dhe 20% shërbime të tjera. Krijimi i një raporti të tillë në mes të mësimdhënies dhe hulumtimit pa dyshim që do të mundësonte rritjen e cilësisë së studimeve të doktoratës, pasi profesorët mentorë do të thellonin ekspertizën e tyre për t'i udhëhequr në mënyrë cilësore përgatitjet e temave të studentëve doktoralë.

Mirepo, për ta kuptuar më mirë gjendjen aktuale në këtë fushë, duhet theksuar të dhënat që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) i ka paraqitur në vitin 2016 për numrin e publikimeve shkencore (të indeksuara në dy bazat më prestigjioze të të dhënave, Scopus dhe Web of Science), ku thuhet që numri i i atyre që kanë publikuar hulumtime të tilla në dhjetë vitet e fundit sillet rreth 100.⁵³

Mirëpo, edhe në rastin e profesorëve që janë të orientuar kah aktivitetet hulumtuese dhe ato të botimit ndërkombëtar, nuk ekziston ndonjë prirje institucionale që ata të lirohen nga obligimet e mësimdhënies, dhe posaçërisht në nivelet më të ulëta, ashtu që të kenë më tepër kohë për t'u përqendruar në aktivitetet e tyre hulumtuese-botuese. Kështu, këto aktivitete të

⁵¹ *Ibid.* .

⁵² *Dokumenti i bardhë: Modeli financiar për Sistemin e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë* (FAITH: Rritja e autonomisë financiare dhe llogaridhënies së institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë), 544142-TEMPUS-1-2013-1-AT-TEMPUS-SMGR.

⁵³ *Kosova larg rajonit me hulumtime shkencore*, Koha Ditore, e hënë, 6 nëntor 2017, fq. 5.

tyre mbeten më tepër fryt i entuziazmit të tyre individual, se rezultat i hulumtimeve që zhvillohen brenda dhe me përkrahjen e Universitetit të Prishtinës,⁵⁴ meqë as 0.1% e buxhetit të tij nuk ndahet për hulumtime shkencore.⁵⁵ Nga ana tjetër, praktika ka dëshmuar që një numër profesorësh, ndërkohë që ankohen që nuk kanë kohë për të bërë hulumtime, vrapojnë pas mbinormave në Universitetin e Prishtinës, ose pas angazhimeve në universitetet e tjera. Ndryshimi i proporcionit midis mësimdhënies dhe hulumtimit shkencor duket iluzor nëse hulumtimi nuk stimulohet financiarisht, dhe njëkohësisht nuk ju ndalohej profesorëve të Universitetit të Prishtinës angazhimi në universitetet e tjera në Kosovë.

Pos numrit tejet të vogël të hulumtimeve, duhet patur parasysh edhe faktin që raporti i rekomanduar nga *Dokumenti i Bardhë* midis hulumtimit dhe mësimdhënies nuk mund të sigurohet në një të ardhme të afërt. Shkak për këtë është edhe numri i madh i studentëve në nivelin bachelor dhe master, gjë që vështirëson angazhimin e profesorëve të rregullt dhe të asocuar në studimet doktorale. Kështu, duhen gjetur alternativa për sigurimin e cilësisë së studimeve doktorale. Një mundësi për trajtimin e këtij problemi do të ishte bashkëmentorimi me ko-mentorë që janë profesorë të universiteteve të jashtme, gjë që tashmë është duke u zbatuar në kuadrin e programit doktoral TEMPUS në Ekonomi (Ekonomiks).⁵⁶ Megjithatë, vetëm ko-mentorimi mund të jetë një zgjidhje e pjesshme nëse nuk rriten kapacitetet vetanake të profesorëve për mentorim. Lidhur me këtë çështje Krasniqi e jep edhe idenë lidhur me aftësimin adekuat të profesorëve për mentorim, përkatësisht, përmes trajnimit me ekspertë të fushave specifike për stilet e mentorimit dhe certifikimin për mentorë përmes dhënies së provimit të mentorimit, ashtu edhe si është praktikë në Britaninë e Madhe.⁵⁷

Një opsion tjetër për rritjen e nivelit të hulumtimeve dhe kyçjen e studentëve të doktoratës në hulumtime do të ishte përmes funksionalizimit dhe zhvillimit të instituteve shkencore brenda fakulteteve të UP-së, të cilat ekzistojnë vetëm në letër.⁵⁸ Sipas profesoreshës në Fakultetin Juridik, Dr. Gjuljeta Mushkolaj, pa institute shkencore nuk mund të pritët që të zhvillohet

⁵⁴ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017.

⁵⁵ Intervistë But Dedaj, 28 gusht, 2017.

⁵⁶ Ibid., Këtu bëhet fjalë për Universitetet evropiane me të cilat është duke u realizuar programi doktoral i TEMPUS-it: Universiteti i Lincit, Universiteti i Peskaras dhe Universiteti i Nicës.

⁵⁷ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017.

⁵⁸ Intervistë, Gjuljeta Mushkolaj, 14 shtator 2017.

shkenca brenda UP-së, përfshirë këtu edhe kyçjen e kandidatëve doktorale në projekte shkencore.⁵⁹ Mirëpo, studentët doktorale shpesh herë nuk kanë ndonjë aftësim paraprak, dhe as ndonjë përvojë, në dizajnimin dhe përgatitjen e projekteve hulumtuese që do të mund të dëshironin t'i propozojnë.⁶⁰ Për më tepër, aftësimi i studentëve doktorale në këtë fushë, në studimet doktorale, do të mundësonte edhe kyçjen e tyre të efektshme në projektet hulumtuese të instituteve shkencore.

Megjithatë, për funksionalizimin e këtyre instituteve do të duhej të krijohet edhe infrastruktura e domosdoshme, përfshirë këtu edhe xhirollogaritë e veçanta të tyre, pasi kjo do të mundësonte marrjen e donacioneve nga jashtë apo gjenerimin e të ardhurave përmes hulumtimit për sektorë të tjerë. Në botën e zhvilluar institutet e universiteteve kanë mundësi të gjenerimit të të ardhurave, kanë mundësi të bashkëpunimit me institute të tjera, si vendore, ashtu edhe ndërkombëtare.⁶¹

Një mundësi tjetër për zbutjen e problemit të mungesës së hulumtimit nga radhët e profesorëve të rregullt dhe të asocuar që ndërlidhet me studimet doktorale është edhe opsioni i studimeve doktorale interdisciplinare, gjë që edhe parashihet me Rregulloren për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës.⁶² Në rrethanat ekzistuese, interdisciplinariteti mund të ofrohet vetëm përmes bashkëpunimit ndërmjet fakulteteve të UP-së. Mirëpo, sipas Qerimit, fakti që programe doktorale të akredituara ka vetëm Universiteti i Prishtinës, e kufizon deri në një masë, mundësinë e eksplorimit të ideve alternative për krijimin e ndonjë shkolle ose programi alternativ për studime doktorale ndërdisciplinare.⁶³ Ky kufizim, sipas Mushkolajt, do të mund të tejkalohet përmes organizimit të këtyre studimeve me universitete jashtë vendit,⁶⁴ dhe sidomos me ato nga rajoni.⁶⁵

Një mungesë jetike për sigurimin e cilësisë së hulumtimit në UP është edhe jo-transparenca, pra, pamundësia në qasjen e punimeve të doktoratës, dhe luftimi i plagjiaturës. Sipas Qerimit,

⁵⁹ *Ibid.*

⁶⁰ Intervistë, Remzije Istrefi, 7 shtator 2017.

⁶¹ Intervistë, Gjuljeta Mushkolaj, 14 shtator 2017.

⁶² Neni 6, Pika 3, Rregullore për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës, 2 shtator 2016.

⁶³ Intervistë, Qerim Qerimi, 17 gusht 2017.

⁶⁴ Intervistë, Gjuljeta Mushkolaj, 14 shtator 2017

⁶⁵ Intervistë, Enver Hasani, 26 korrik 2017.

çështja e plagjiaturës ka mbetur në përgjegjësinë e kandidatit, të mbikëqyrësit të tij, dhe të komisionit që e bën vlerësimin e temës doktrale. Temat e doktoratës para mbrojtjes shpallen publikisht në uebfaqe të UP-së, dhe disa kopje të shtypura lihen në zyrat e administratës së studimeve doktrale. Megjithatë, këto veprime nuk mund ta zëvendësojnë softuerin anti-plagjiat, meqë, pavarësisht nga fakti që punimi mund të shpallet në ueb-faqe për disa javë a muaj, gjithmonë ekziston mundësia që atë të mos e lexojë askush, apo edhe ta lexojë dikush që nuk e vëren plagjiaturën nëse ajo ekziston.⁶⁶

Për më tepër, është i pakuptueshëm fakti që temat e mbrojtura të doktoratës largohen nga ueb-faqja e UP-së pasi të bëhet mbrojtja e tyre, gjë që ndikon në degradimin e transparencës por edhe të heqjes së mundësisë të shfrytëzimit publik të dijës së gjeneruar apo edhe të detektimit të plagjiaturës nga palët e treta. Temat e doktoraturës që nuk kalojnë nëpër testin e plagjiaturës, sidomos përmes trajtimit softuerik të tyre, vejnë në dyshim edhe cilësinë e tërësishme të studimeve doktrale në UP.

Megenëse temat e doktoratës në UP janë të shkruara në shumicën e rasteve në gjuhën shqipe, dhe vetëm në raste sporadike në atë angleze, çështja e softuereve anti-plagjiatë ngatërrohet pasi ato kryesisht përdoren për punimet në gjuhën angleze. Për t'i avancuar studimet e doktoratës, si dhe integrimin në komunitetin shkencor ndërkombëtar, është e nevojshme që të paktën temat e doktoratës të shkruhen në gjuhën angleze, dhe kjo, përpos zgjidhjes së sfidës për të qenë të testueshme në softuerin e hetimit të plagjiaturës, do të mundësonte njëkohësisht edhe aplikimin e suksesshëm të ko-mentorimit me profesorë ndërkombëtarë.⁶⁷

Krahas çështjes së plagjiaturës, një problem tjetër serioz që ndikon në zhvillimin e hulumtimit në UP, përfshirë këtu edhe përgatitjen e temave cilësore të doktoratës, është mungesa e bibliotekave elektronike, përkatësisht, qasja në revistat shkencore ndërkombëtare. UP për një kohë ka patur një qasje në disa nga bibliotekat elektronike, të cilën me një donacion e kishte sponsoruar Ambasada Amerikane në Kosovë. Mirëpo, më vonë, kjo qasje ishte ndërprerë,

⁶⁶ Intervistë, Qerim Qerimi, 17 gusht 2017.

⁶⁷ Intervistë, But Dedaj, 28 gusht 2017.

meqë, sipas Krasniqit, numri i klikimeve dhe shkarkimeve nga Universiteti i Prishtinës kishte qenë tejet i vogël për ta arsyetuar pagesën mjaft të lartë që bëhej për këtë qasje.⁶⁸

Përndryshe, kjo e dhënë është tejet indikative, meqë e vë në pyetje atë se sa kërkohet përcjellja e punimeve shkencore ndërkombëtare si nga ana e profesorëve dhe mentorëve, ashtu edhe nga doktorantët. Po ashtu, një çështje tjetër që del në sipërfaqe në këtë situatë, është çështja e llojit të literaturës që shfrytëzohet për të bërë studimet doktorale cilësore, të cilat nëse bazohen kryesisht në libra, e që si rrjedhojë mund ta ketë shkëputjen nga trendet e të arriturave bashkëkohore ndërkombëtare, të cilat kryesisht gjenden në revista shkencore. Dhe janë pikërisht këta artikuj ata në të cilët duhet të përqendrohet çdo person që bën hulumtime serioze për doktoraturë, pasi ajo nënkupton arritjen e rezultateve të reja shkencore që nuk janë të evidentuara më parë.⁶⁹

⁶⁸ Intervistë, Besnik Krasniqi, 4 shtator 2017.

⁶⁹ Intervistë, Gazmend Qorraj, 6 shtator 2017.

3. KONKLUZIONE PËR DISKUTIM

A) Agjencioni i Kosovës për Akreditim ka shërbyer deri më tash më tepër si një mekanizëm për verifikim formal të plotësimit të kushteve për studimet doktorale, pa u përqendruar në dimensionet përmbajtësore, si cilësia e personelit akademik dhe e planprogramit. Vërejtjet kryesore që u parashtruan në intervista kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të profesorëve dhe mentorëve në studimet doktorale sa i përket njohjes së gjuhës angleze, apo të gjuhëve të tjera botorërore, si dhe të kompetencave të tyre për hulumtim shkencor.

Çështjet për diskutim:

- Ndryshimi i procesit të vlerësimit nga ana e ekspertëve të jashtëm për studimet doktorale, përmes krijimit të një komisioni të veçantë të ekspertëve të jashtëm që kanë përvojë të dëshmuar në ofrimin e studimeve doktorale, dhe që do të merreshin me akreditim vetëm për këtë nivel të studimeve.
- Ndarja e kriterit të akreditimit të programeve doktorale nga titujt e profesorëve universitarë, përmes akreditimit të profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim, me ç'rast ata do të vlerësoheshin përmes hulumtimeve, përkatësisht punimeve shkencore, dhe jo përmes titujve universitarë, të cilët mjaft shpesh nuk korrespondojnë me kompetencat e bartësve të tyre.
- Ko-mentorimi si një zgjidhje e pjesshme nëse nuk përcillet me rritjen e kapaciteteve vetanake të profesorëve për mentorim, si dhe me aftësimin adekuat të tyre për këtë. Trajnimi nga ekspertë të fushave përkatëse për stilet e mentorimit dhe certifikimin për mentorë, e cila bëhet përmes dhënies së provimit të mentorimit.
- Për avancimin e studimeve të doktoratës dhe integrimin në komunitetin shkencor ndërkombëtar duhet shqyrtuar mundësia që temat e doktoratës të shkruhen në gjuhën angleze. Kjo, pos asaj që punimet e doktoratave do t'i bënte të testueshme në softuerin për detektimin e plagjiaturës, njëkohësisht do ta mundësonte edhe aplikimin e suksesshëm të ko-mentorimit me profesorë ndërkombëtarë.

B) Konkursi për pranim në programet doktorale ka përfshirë organizimin e një provimi me shkrim për kandidatët, dhe ky ka mbartur me vete një vlerë totale të pikëve që ka qenë më e madhe se shuma e tërësishme e pikëve që i mbartnin të gjitha kriteret e tjera së bashku, të tilla si njohja e gjuhës së huaj, botimet e ndryshme me recension ndërkombëtar, etj. Po ashtu, numri i studentëve doktorale është në shpërputhje të theksuar me kapacitetet mentoruese të profesorëve, dhe kjo në një masë të madhe e dëmton cilësinë e studimeve dhe të hulumtimit doktoral. Për më tepër, në të kaluarën ka patur studentë që janë pranuar edhe pa e njohur anglishten, gjë që është pengesë thelbësore për zhvillimin e hulumtimeve shkencore dhe për arritjen e cilësisë adekuate të punimeve të doktoratave.

Çështjet për diskutim:

- Nevoja për organizimin e provimeve pranuese për kandidatët për studime doktorale, dhe çfarë duhet të jetë vlera e këtij provimi krahasuar me kriteret e tjera për pranimin e tyre.
- Sigurimi i proporcionalitetit midis numrit të studentëve doktoral dhe atij të mentorëve potencialë.
- Nevoja që kriteri i domosdoshëm dhe eliminues për pranim të kandidatëve në të ardhmen të jetë kalimi i testit në TOEFL.

C) Ndryshimet e deritashme të strukturave udhëheqëse të UP-së, përkatësisht, të rektorit, rëndom janë përcjellur me ndryshimin e rregullativës për studimet e doktoratës. Moskonsistenca administrative rezultuese ka qenë njëri ndër faktorët që kanë shkaktuar probleme shumë të mëdha në zbatimin e studimeve doktorale të deritashme.

Çështjet për diskutim:

- Domosdoshmëria e konsistencës administrative në studimet doktorale me rastin e ndërrimit të strukturave menaxhuese të Universitetit.

D) Kërkesa që një pjesë e konsiderueshme e disertacionit të doktoratës të kandidatit duhet të botohet në një revistë shkencore ndërkombëtare nga fusha përkatëse, e cila ka recension ndërkombëtar, dhe që është me impakt-faktor ndërkombëtar.

Çështjet për diskutim:

- Duke patur parasysh konkurrencën për botime në revistat ndërkombëtare me impakt-faktor, si dhe procesin tejet të gjatë të recensionit të dorëshkrimeve nëpër këto revista, ky kusht, me shumë gjasë do ta bllokojë progresin e studentëve në përpjekjet për t'i kryer studimet e tyre të doktoratës.

E) Krijimi i një raporti dominues të hulumtimit në raport me mësimdhënien do ta mundësonte rritjen e cilësisë së studimeve të doktoratës, meqë profesorët mentorë do të thellonin ekspertizën e tyre për t'i udhëhequr në mënyrë cilësore përgatitjet e temave të studentëve doktoralë. Në UP nuk ekziston ndonjë prirje institucionale që profesorët e prirur ndaj hulumtimit të lirohen nga obligimet e mësimdhënies, dhe posaçërisht në nivelet më të ulëta, ashtu që të kenë më tepër kohë për t'u përqendruar në aktivitetet e tyre hulumtuese-botuese. Hulumtimet shkencore janë rezultat i punës të profesorëve të veçantë, më tepër se rezultat i projekteve hulumtuese që zhvillohen brenda dhe me përkrahjen e Universitetit të Prishtinës, meqë as 0.1% e buxhetit të UP nuk ndahet për hulumtime shkencore.

Çështjet për diskutim:

- Ndryshimi i proporcionit midis mësimdhënies dhe hulumtimit shkencor duket iluzor nëse hulumtimi nuk stimulohet financiarisht, dhe nëse njëkohësisht profesorëve të Universitetit të Prishtinës nuk ju ndalohet angazhimi në universitetet e tjera në Kosovë.
- Për përgatitjen e temave cilësore të doktoratës, është i domosdoshëm sigurimi i qasjes në bibliotekave elektronike, përkatësisht, qasja në revistat shkencore ndërkombëtare.

- Rritja e nivelit të hulumtimeve dhe kyçja e studentëve të doktoratës në hulumtime përmes funksionalizimit dhe zhvillimit të instituteve shkencore brenda fakulteteve të UP-së, që tash për tash ekzistojnë vetëm në letër.
- Eksplorimi i ideve për krijimin e ndonjë shkolle ose programi alternativ për studime doktorale ndërdisiplinare përmes organizimit të këtyre studimeve me universitete jashtë vendit, dhe sidomos me ato nga rajoni.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është përkrahur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).